

| | |
|---------------------------------------|---|
| Emri i projektit: | Shërbimet e Rehabilitimit Bazuar në Komunitet për fëmijët me aftësi të kufizuara. |
| Kohëzgjatja: | 01.12.2020 – 31.03.2021 |
| Shtrirja gjeografike: | Ferizaj |
| Buxheti total i grantit (EUR): | 9.400.00€ |
| Objektivat: | <p>Ofrimi shërbimeve holistike dhe multi disiplinare rehabilituese me bazë në komunitet të cilësisë së lartë për fëmijët me aftësitë kufizuar që të ju mundësohet integrimi i plote i tyre në shkollë dhe në komunitet.</p> <p>Mbeshtetja e familjeve për ndertimin e rezilencës dhe aftësimin e tyre për të përkeqësuar zhvillimin fizik, shoqëror dhe arsimor të fëmijëve të tyre dhe avokimin për të drejtat e fëmijëve të tyre për arsimim, shëndetësi dhe përfshirje sociale.</p> |
| Grupet e synuara: | Grupet e synuara janë fëmijë me aftësi të kufizuara (djem dhe vajza) të grup-moshës 3- 14 vjeç dhe familjet e tyre. Gjithsej 30 fëmijë dhe prindërit e 30 fëmijëve do të përfitojnë nga shërbimet e integruara. Fëmijët janë identifikuar përmes databazës së plotësuar nga Handikos Ferizaj ndër vite, përmes bashkëpunimit me Qendrën e Mjekësisë Familjare, Qendrën për Punë Sociale dhe partnerëve tjerë lokal. |
| Përmbledhje e grantit: | <p>Projekti orientohet nga parimi i respektimit të të drejtave, i të qenurit një ambient i hapur, i respektueshëm dhe me një sjellje të natyrës pjesëmarrëse ku mendimi i përfituesve të shërbimit kërkohet dhe merret në konsideratë, pavarësisht faktorëve dhe prapavijave sociale që i rrethojnë ata. Ofrimi i shërbimeve mbështetet në parimin për të kontribuar në ngritjen e një modeli të qëndrueshëm integrimi e zhvillimi, i cili synon të garantojë për të gjithë mundësinë e përmbushjes së nevojave bazike, si edhe një perspektivë zhvillimi të qëndrueshëm për të ardhmen.</p> <p>Të gjitha aktivitetet do të organizohen në mënyrë që të mbështeten kapacitetet psiko-emocionale të prindërve dhe të rriten njohuritë dhe aftësitë e tyre në mbështetjen e zhvillimit të fëmijëve të tyre dhe avokimit për të drejtat e fëmijëve me aftësi të kufizuara.</p> <p>Shërbimet multidisiplinare për fëmijët me aftësi të kufizuara do të ofrohen në përputhje me nevojat e vlerësuara, terapi individuale, në shkollë, terapi në shtëpinë ku jeton përfituesi, vlerësim nevojash, informim, këshillim për prindërit, ndihmë ligjore, orientim drejt shërbimeve publike e jopublike, fuqizim kapacitetesh të prindërve dhe punonjësve të shkollave, shërbime psiko-sociale, etj. Për më tej, në kuadër të projektit, qendrat kanë arritur të realizojnë ndikimin e tyre edhe në komunitet, përmes fushatave të ndryshme të organizuara përgjatë këtyre viteve, takimeve të rregullta me komunitetin për ndërgjegjësim, dhe fuqizimin e akterëve tjerë në komunitet për të zgjeruar ndikimin dhe për të arritur një qëndrueshmëri më të lartë të shërbimeve të ofruara.</p> |
| Donatori: | Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale |

